| Të dhëna identifikuese të personit jo rezident (Emri) <i>Identification information on non-resident associated parties (Name)</i> | Rezidenca tatimore (<i>Tax Residence</i>) | Pa interes (<i>Interest free</i>) | | Balanci në fillim të periudhës raportuese në lekë <i>Opening balance at beginning of reporting period in ALL</i> | Balanci në mbyllje të periudhës raportuese në lekë <i>Closing balance at end of tax year in ALL</i> |
|--|--|--|---------------------|---|--|
| | | Po (<i>Yes</i>) | Jo (<i>No</i>) | | |
| | | | | | |

10. Ju lutem përshkruani ndryshime (nëse ka) në strukturën ligjore të grupit apo ndryshime të tjera në funksionet e ushtruara, asetet e përdorura dhe rreziqet e marra.

Please describe changes (if any) to the legal structures of the group or other changes regarding functions exercised, assets used or risks assumed.

11. Ju lutem, listoni transaksionet e kontrolluara që lidhen me blerjen ose tjetërsimin e aktiveve kapitale (të trupëzuara ose të pa trupëzuara) / *Please, list the controlled transactions related to acquisition or alienation of capital assets (tangible or intangible).*

Transaksionet kapitale / *Capital Transactions*

Të dhëna
identifikuese të
personit jo rezident
(Emri)

Të lidhura
(Associated)
Po (Yes) Jo (No)

Rezidenca tatimore
(Tax Residence)

Të ardhura nga
tjetërsimi (Proceeds
from alienation)

Çmimi i blerjes
(Purchase price)

Identification
information on non-
resident associated
parties (Name)

12. A keni ofruar mallra apo shërbime tek palët e lidhura pa pagesë ose pa shpërblim?
(Did you provide any goods or services to associated parties for non monetary or no consideration)?

Po (Yes)

Jo (No)

13. A keni marrë mallra apo shërbime nga palët e lidhura pa pagesë ose pa shpërblim?
(Did you receive any goods or services to associated parties for non monetary or no consideration)?

Po (Yes)

Jo (No)

Pjesa e III: Të përgjithshme
(Part III) General

14. Kodet e transaksioneve / Transactions codes.

| Lloji i transaksionit/ Type of transaction | Kodi i transaksionit/ Transaction Code |
|--|---|
| Aktive materiale / Tangible goods | A |
| Lëndë të para / Raw materials | A1 |
| Mallra të përfunduara / Finished goods | A2 |
| Pagesa të tjera për aktive materiale / Other payments for tangible goods | A3 |
| Aktive jo-materiale / Intangible | B |
| Honorare/ Royalties | B1 |
| Qera (të ndryshme nga honoraret) / Rent (Other than royalty) | B2 |
| Pagesa të tjera për aktive jomateriale / Other payments for intangible | B3 |
| Shërbimet / Services | C |

| | |
|--|----------|
| Shërbime Menaxhimi / <i>Management</i> | C1 |
| Shërbime Administrimi / <i>Administration</i> | C2 |
| Shërbime Teknike / <i>Technical</i> | C3 |
| Shërbime Marketingu/ <i>Marketing</i> | C4 |
| Kërkim dhe zhvillim/ <i>Research and development</i> | C5 |
| Trajnime / <i>Trainings</i> | C6 |
| Komisione / <i>Commissions</i> | C7 |
| Shërbime të tjera / <i>Other services</i> | C8 |
| Shërbime financiare dhe sigurimi / <i>Financial and insurance</i> | D |
| Interesa / <i>Interest</i> | D1 |
| Zbritjet / <i>Discounts</i> | D2 |
| Siguracione / <i>Insurance</i> | D3 |
| Pagesa garancie / <i>Guarantee fees</i> | D4 |
| Të tjera shërbime financiare/ <i>Other financial services</i> | D5 |
| Çdo e ardhur ose shpenzim tjetër / <i>Any other income or expense</i> | E |
| Alokim shpenzimesh / <i>Recharge of expenses</i> | E1 |

15. Shkurtime:

Abbreviations:

Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar (CUP) / *Comparable Uncontrolled Price (CUP) Method*

Metoda e Çmimit të Rishitjes (RP) / *Resale Price (RP) Method*

Metoda Kosto Plus (CP) / *Cost Plus (CP) Method*

Metoda e marzhit neto Transaksional (TNMM) / *Transactional Net Margin Method (TNMM)*

Metoda e ndarjes se fitimit (SPM) / *Profit split method (SPM)*

Metoda të tjera (OM) / *Other Methods (OM)*

16. Çertifikim mbi saktësinë

Certification on the accuracy

Unë vërtetoj se informacioni i dhënë në këtë deklaram dhe në çdo dokumentacion që i bashkëngjitet atij është i njohur nga ana ime, është përgatitur në mirëbesim, bazuar në informacionin dhe evidence më të mire të disponuar.

I certify that the information given in this form and in any documents attached is prepared in good faith, based on the best information and evidence possessed.

Emri dhe Mbiemri i Administratorit/Drejtorit *Gezim DOBI*

Nënshkrimi
Signature

Gezim Dobi



SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

I. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "InfoSoft Office" Sh.p.k është regjistruar në regjistrin tregtar të shoqërive, me vendim gjykatë nr. 7107 datë 30.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Tiranë.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti i veprimtarisë: Import-Export dhe tregtim të artikujve kancelarik, konsumablave etj. Ofrues të shërbimeve të printimit, qiradhenie dhe tregtim të pajisjeve të printimit dhe hardware, menaxhim të sistemeve të printimit Pay Per Use dhe Pay Per Print, krijim dhe mirëmbajtje rrjetesh kompjuterike, informatike, dhe elektronike, import-export dhe tregtim të konsumablave për pajisje të ndryshme, tonerave, lodrave, etj. Cdo veprimtari tjetër të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Certifikimi tatimor: NUIS J62426002Q

Kapitali themeltar: 136,116,760 leke, i ndarë në 2 (dy) kuota, me vlerë nominale 68.058.380 leke secila.

Kuotat e pronësive:

- Shoqëria "Dobi Management" sh.p.k, zoterues i 1 kuote, që përben 50 % të kapitalit të regjistruar dhe
- Z.Frederik Prodani, zoterues i 1 kuote, që përben 50 % të kapitalit të regjistruar.

Administrator i Përgjithshëm: Z.Gezim Dobi me të drejta dhe detyra të percaktuara në statutin e shoqërisë, me afat emerimi deri më 13/12/2022.

Forma juridike e shoqërisë: SH.P.K

Adresa Kryesore e aktivitetit: - Tiranë, Kashar, KASHAR, Koder Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, KM 8 Zona Kadastrale 2119, Nr. Pasurie 164/54, Tiranë, Shqipëri.

Adresa sekondare :

- Tiranë Tiranë TIRANË Rruga "Mihal Duri" nr.36/1. Tiranë
- Tiranë, Tiranë TIRANË Njësia Administrative Nr.2, Rruga Murat Toptani, Godina "Gjergji Center" Tiranë
- Tiranë, Tiranë, TIRANË Njësia Administrative Nr.5 Rr."Abdyl Frasheri" pall.9

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente në pronësi të saj si dhe në ambiente që janë të mara me qira, për zyra dhe magazina, të cilat janë të pajisura me nipte sekondare. Mjetet e transportit janë në pronësi të shoqërisë.

Numri i punonjësve më datë 31 Dhjetor 2020 ka qenë 88 punonjës, ndërsa në 31.12.2019 ishte 90 punonjës.

Permbledhje e Politikave Kontabel

II. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

II.1. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"). Shoqëria mban kontabilitetin dhe raporton pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 64 datë 22.07.2014 dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me efekt nga data 1 janar 2019. Bazat e vlerësimit janë pershkruar në mënyrë me të qartë në politikat kontabel të paraqitura si më poshtë.



II.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

II.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("LEKE"), e cila është monedha funksionale apo e mjedisit ekonomik kryesor, në të cilin vepron Shoqëria. Monedha e paraqitjes është Lek shqiptar ("LEKE"). Të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveçse ku shprehet ndryshe.

II.4 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që Shoqëria ka burime të mjaftueshme dhe perspektivë për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë paisigurie materiale, që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

Kompesimi (netimi)

Aktivitetet dhe detyrimet financiare janë të kompensuar me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm në qoftë se ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe Shoqëria ka një synim për t'i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitetet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim kontabël.

III. Gjykime të rëndësishme kontabel, vlerësime dhe supozime.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon, që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

- vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
- vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit dhe i zhvlerësimeve të aktiveve;
- krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove, që lidhen me procedurat gjyqësore në proces. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njih detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumën që ishin regjistruar fillimisht, diferenca do ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

IV. Përmbledhje e politikave kontabël.

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël, që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me kosto historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare behet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse percaktohet ne SKK 3, ndersa te aktivet dhe pasivet e tjera duhet ti referohemi rast pas rasti SKK-ve perkatese.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato flukse që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital.

Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri

Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (a) njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;
- (b) njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;
- (c) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- (d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike;
- (e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri

Kontratat e shërbimit

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).

Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat perkatese. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njesia ekonomike nuk prët përfitime të ardhshme, njihen menjehere në rezultatin financiar.

Transaksionet e qirase

Qiraja është një marrëveshje ku qiradhënësi i kalon qiramarrësit të drejtën e përdorimit të një aktivi për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt një ose disa pagesave. Marrëveshjet e qirasë do të klasifikohen ose si qira financiare ose si qira e zakonshme. Faktori përcaktues për klasifikimin e qirave është niveli deri ku rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e një aktivi të dhënë me qira i takojnë qiramarrësit apo qiradhënësit.

Meqenëse transaksioni mes qiradhënësit dhe qiramarrësit bazohet në një marrëveshje qiraje të përbashkët, që është e detyrueshme për të dyja palët, të dyja palët duhet të përdorin të njëjtat përkufizime kur bëjnë klasifikimin e marrëveshjeve të qirasë. Nga ana tjetër, meqenëse të dyja palët përdorin supozime të ndryshme për klasifikimin e marrëveshjeve të qirasë, në rrethana të caktuara, qiradhënësi dhe qiramarrësi mund të klasifikojnë të njëjtën marrëveshje qiraje në mënyra të ndryshme.

Qiraja financiare është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivit. Titulli mund t'i kalojë ose jo qiramarrësit.

Qiraja e zakonshme është çdo lloj qiraje tjetër, përveç asaj financiare, d.m.th. është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit nuk i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivit.

Inventarët

Inventarët janë aktivet e mbajtura nga shoqëria për shitje në rrjedhën normale të aktivitetit të saj. Ajo njeh inventarin atëhere kur e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Pas njohjes fillestare njesia ekonomike e mat inventarin me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur. Për të përcaktuar koston e inventarit shoqëria përdor metodën e kostos mesatare të ponderuar.

Intrumentat financiare

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njesie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njesie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njesite ekonomike pjesë e grupit, huamarrjet dhe huadheniet.

Aktivitetet financiare

Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njesia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njesia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Në këto ze janë përfshirë kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, hua si dhe kërkesa të tjera debitore afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat në njohjen fillestare janë vlerësuar me vlerën e paskontuar apo me koston e transaksionit. Pas njohjes fillestare, aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivit financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësi duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, ortakëve për dividendë, hua dhe interesa, punonjesve, administrates tatimore, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një aktivit financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale paguhen, anulohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

Kompensimi

Aktivitetet dhe Detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumën dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, si pjesë e aktiveve financiare, përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara ose me maturitet tre muaj ose më pak, të percaktuara si më sipër.

Detyrime/të drejta tatimore

Si pjesë e një aktivit apo detyrimi financiar, të drejtat dhe detyrimet tatimore përfshijnë të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të paguara dhe për tu paguar ndaj administrates tatimore, të cilat vlerësohen me kosto

(me vlere te paskontuar). Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontohen dhe nuk zhvleresohen.

Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale (AAM dhe AAJM)

Aktivitet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që përdoren nga njësi ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t'ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, për më shumë se një periudhë kontabël. Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto dhe paraqiten në pasqyrat financiare me vlere neto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka klasifikuar si aktive afatgjata materiale inventarët që përdoren për qëllime administrative dhe perbehen nga toka, ndertesa, mjete transporti, pajisje informatike, mobilje e pajisje zyre, etj. Aktivitet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet normale për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM e shoqërisë, është metoda e vlerësimit mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuar janë paraqitur në tabelën më poshtë:

| Pershkrimi | Norma vjetore | Metoda |
|---------------------|----------------------|-------------------|
| Pajisje informatike | 25% | Me vlere e mbetur |
| Mobilje e orendi | 20% | Me vlere e mbetur |
| Ndertesa | 5% | Me vlere e mbetur |
| Te tjera | 20% | Me vlere e mbetur |
| Toka | 0% | |

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Tokat dhe Aktivitet në proces nuk amortizohen.

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Aktivitet afatgjata të investuara

Aktivitet afatgjatë material i investuar është pasuria (tokë ose një ndërtesë ose një pjesë e ndërtesës, apo të dyja) e mbajtur nga pronari ose qiramarrësi sipas një kontrate qiraje financiare për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit ose të dyja, me përjashtim të rasteve kur:

- (a) përdoret në prodhimin ose furnizimin e mallrave apo shërbimeve ose për qëllime administrative, ose
- (b) shitet në rrjedhën e zakonshme të biznesit.

Një njësi ekonomike duhet të masë aktivitet afatgjatë të investuar me koston e tij në njohjen fillestare.

Vlerësimi i mëpasshëm

Aktivi afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë të raportimit me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje. Një njësi ekonomike duhet të trajtojë të gjitha aktivet e tjera të investuara si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim. Shoqëria ka si aktive afatgjata investimi vetem tokë, për të cilët nuk llogaritet amortizim. Jetëgjatesia dhe metoda e amortizimit për aktivet e amortizueshme, rishikohet çdo fund periudhe raportuese dhe rregullohet prospektivisht nëse është e nevojshme.

Provizionet

Provizioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose kontraktual dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh (përfitimet ekonomike) për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet.

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

Kapitali

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kuota e kapitalit, e cila përfaqëson kontributin e ortakëve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Kapitali njihet me kosto, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërisë.

Te ardhura të tjera dhe shpenzime financiare

Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e interesit efektiv (kontabilizimi, në bazë të normës së brendshme të interesit efektiv, përshkruhet gjithashtu në SKK 3, Instrumentet Financiare); Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare si dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). Të ardhurat nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto.

Tatimi mbi të ardhurat

Tatim fitimi përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferencën të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit

financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimet e lidhura me atë takse do të realizohen.

Transaksionet ne valute te huaj

Regjistrimet kontabël të shoqërisë përgatiten në Lek (ALL), që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin. Kurset e këmbimit të përdorura për vlerësimin e gjendjeve në monedhe tjetër me date 31.12.2020 dhe 31.12.2019 janë:

| Monedha | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|---------|------------|------------|
| EUR | 123.7 | 121.77 |
| USD | 100.84 | 108.64 |

1. Mjete monetare dhe të ngjashme

Gjendjet e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten të detajuara si më poshtë:

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|-----------------------------|-------------------|-------------------|
| Llogari ne banke | 37,836,357 | 25,340,091 |
| Llogari rrjedhese ne LEK | 30,380,070 | 23,914,966 |
| Llogari rrjedhese ne EUR | 7,246,559 | 1,163,699 |
| Llogari rrjedhese ne USD | 209,728 | 261,427 |
| Para ne dore | 1,761,454 | 830,920 |
| Ne monedhe vendase | 1,664,404 | 813,250 |
| Ne monedhe te huaj | 97,050 | 17,670 |
| Total mjete monetare | 39,597,810 | 26,171,011 |

Vlera e mesiperme perfaqeson vleren e likuiditeteve me date 31.12.2020 gjendje ne llogarite qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ne leke dhe valute si dhe gjendjen ne arke. Gjendja e likuiditeteve (ne banke) e paraqitur ne bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankes.



Handwritten signature or initials in blue ink.

2. Te drejta te arketueshme

2.a Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|--|--------------------|--------------------|
| Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit | 142,941,539 | 198,381,198 |
| Të arkëtueshme nga palet e lidhura | 31,750,210 | 6,520,373 |
| Shuma te parash per zhvleresimin e klienteve | -18,546,131 | (12,882,898) |
| TOTAL | 156,145,618 | 192,018,673 |

Ne kete rubrike jane paraqitur te drejta te kompanise ndaj klienteve per shitjet e realizuara dhe te pa likuiduara deri ne daten e mbylljes se bilancit si dhe zhvleresimi i llogaritur per faturat e pa likuiduara per me shume se 365 dite.

2.b

Nga njësitet ekonomike brenda grupit

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|----------------------------------|-------------------|------------------|
| Algrafika Shpk | 5,098,950 | 3,634,554 |
| Shtypshkronja Progres Shpk | 263,149 | 0 |
| InfoSoft Office shpk (Prishtine) | 26,363,288 | 2,867,774 |
| Dobi Management Shpk | 24,823 | 18,045 |
| TOTAL | 31,750,210 | 6,520,373 |

Ne kete rubrike paraqiten te drejta te arketueshme te kompanise ne date 31.12.2020 nga njesite e grupit, shuma keto, qe do te arketohen pas kesaj date.

2.c Te drejta te tjera

Ne kete rubrike jane paraqitur kerkesa per tu arketuar nga shteti per tatim fitimi , paradhenie personeli dhe debitore per ankimime ne lidhje me tenderat si dhe procese te tjera gjyqesore, si vijon:

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|--------------------------------|------------------|------------------|
| Paradhenie personeli | 10,000 | 10,000 |
| Shteti tatim fitimi paradhenie | 4,374,132 | 7,795,732 |
| Shteti - Detyrime te tjera | 0 | 494 |
| Deb.Kreditore - Marredhenie Fu | 86,300 | 0 |
| Deb.Kreditore per Procese Gjyq | 1,025,711 | 1,064,645 |
| Total | 5,496,143 | 8,870,871 |

3. Inventarët

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|-------------------------------|--------------------|--------------------|
| Karburant IO | 114,200 | 344,633 |
| Material ambalazhimi.. | 221,040 | 36,000 |
| Mater. te tjera te stokueshme | 293,760 | 0 |
| Shuma | 629,000 | 380,633 |
| Mallra | 226,521,107 | 254,717,944 |
| Parapagimet per inventar | 35,163,973 | 18,210,536 |
| Totali | 262,314,080 | 273,309,113 |

Ne kete rubrike paraqiten gjendjet e inventareve ne kompani ne date 31.12.2020 perkatesisht gjendje e tollonave te karburantit te pa konsumuara, gjendje ambalazhi, gjendja e mallrave ne magazinën e kompanise si dhe vlera e parapagimeve tek furnitorët per inventare te cilat vijne pas dates 31.12.2020.



4. Shpenzime të shtyra

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|--------------------------------|------------------|------------------|
| Parap.shpenz.Interneti | 434,060 | 480,953 |
| Parapagim Siguracion Automjete | 176,557 | 165,446 |
| Parap.Shp Miremb Pajisje Infor | 101,375 | 7,249 |
| Parap Guide Biznesi/Reklam | 27,823 | 14,219 |
| ParapagimCertifikime,emer etj. | 172,886 | 73,200 |
| Sig nga Zjarri Ndertesa | 118,389 | 52,149 |
| Parapagim Shpenzime ADM | 989,658 | 436,244 |
| Parapagim qera | 1,150,241 | 288,799 |
| TOTAL | 3,170,989 | 1,518,260 |

Ne kete rubrike jane paraqitur shpenzime te faturuara ,qe i perkasin periudhes pas 31.12.2020 Pra konsumohen ne vitin 2021.

5. Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara

| Emertimi | 31.12.2020 | 31.12.2019 |
|-------------------------|------------------|------------------|
| Te ardhura per tu marre | 3,691,997 | 9,295,084 |
| TOTAL | 3,691,997 | 9,295,084 |

Ne kete rubrike jane paraqitur te ardhura te llogaritura (te faturuara ne vitin 2021), por qe i perkasin periudhes vitit 2020.

6.Aktivet Afatgjata Materiale

